



Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Drejtoria për Arsim

10 Nr. 679/15

Datë : 17.09.2015

Në mbështetje të Udhëzimit Administrativ nr. 18/2014, datë 29.05.2014, neni 11,12 dhe 13, Drejtoria e Arsimit në Vushtrri shpall:

FTESË PËR OFERTË

Për organizimin e Ekskursionit në Shqipëri me nxënësit maurantë të :
Gjimnazit “Eqrem Çabej”

Ekskursioni do të zgjatë katër bujtje e pesë ditë.

Agjencioni duhet t'i plotësojë kushtet sipas UA nr. 18/2014 të MASHT:

- a) Agjencioni duhet të jetë i licencuar.
- b) Të ketë bërë kontrollin teknik sipas procedurave ligjore
- c) Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës
- d) Autobusët të jenë komfor dhe me klimë
- e) Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit
- f) Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit
- g) Agjencionet të cilat kanë referenca negative nga DA nuk do të hapen
- h) Agjencioni është i obliguar të zbatojë itinerarin e ekskursionit të DA-së
- i) Agjencioni duhet t'i mbulojë shpenzimet e kujdestarëve të klasave dhe shpenzimet e nxënësve në vizitat të monumenteve historike.

Itinerari i ekskursionit merren në DA dhe ofertuesi është i obliguar të zbatoj në përpikëri.

Afati i ofertimit është deri më datën 28.09.2015 ora 12⁰⁰.

Ofertat e ardhura pas afatit, nuk hapen dhe nuk shqyrtohen.

Ofertat dërgohen në DA përmes zyrës së pranimit të KK Vushtrri.

Ofertat hapen më 28.09.2015 në ora 14³⁰ në zyrën e DA-së.